



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljena / Prodato Received / Delivered	18.11.2021	viti god year	2021
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SK/MS/STK	5528/2021		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.849/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtar, dhe Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.849/2021 të datës 05.10.2021, të parashtruar nga ankuesi me adrese "Zenel Salihu" nr.155 komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Ministria Kulturës Rinisë dhe Sportit, në çështjen juridike "Ndërprerje e marrëdhënies së punës" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 18.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.849/2021 të datës 05.10.2021 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi më datë 05.10.2021 ka parashtruar ankesën me numër protokollit 899/2021 të regjistruar me numër A.nr.849/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër reference 2811/2021 të datës 18.08.2021 të Komisionit Disiplinor dhe Vendimit Nr.04/2021 të datës 21.09.2021 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 07.10.2021, ka dërguar kërkesë për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit. Kjo e fundit me datë 18.10.2021 ka dërguar përgjigje së bashku me provat e lëndës.



Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 899/2021 të regjistruar me numër A.nr.849/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 18.08.2021 me numër të protokollit 2811/2021; Vendimin e datës 18.08.2021 me numër të protokollit 2811/2021 të Komisionit Disiplinore të QKK-se; Vendimin e datës 21.09.2021 me numër të protokollit 3348/2021 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Ankesën e datës 25.08.2021 me numër të protokollit 2898/2021 drejtuar Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimin e datës 24.04.2018 me numër të protokollit 193/2018; Raportin e veçantë të datës 28.08.2018 me numër të protokollit 249/2018 lidhur me aplikimin e konkursit 2018 të disa kompanive filmike dhe producentëve; Shkesën lidhur me ndryshimin e testit të kulturës të datës 16.08.2018 me numër të protokollit 47/2018; Shkresën e shkëputur nga gazetatat lidhur me rritjen 100% për buxhetin për Qendrën Kinematografike të Kosovës; Emalin e datës 10.06.2018 dhe të datës 30.06.2018; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë 2019 të datës 27.12.2019 me numër të protokollit 5504/2019; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 25.01.2019 me numër të protokollit 179/2019; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit të datës 15.08.2018 me numër të protokollit 962/2018; Aktin e Emërimit të datës 30.03.2018 me numër të protokollit 962/2018; Aktin e Emërimit të datës 11.03.2014 me numër të protokollit 846/2014; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 07.10.2021 me numër të protokollit 4952/2021; Përgjigja në ankesë e datës 18.10.2021 me numër të protokollit 5084/2021; Raportin e datës 18.06.2021 me numër të protokollit 2031/2021 mbi shkeljet e evidentuara në Qendrën Kinematografisë të Kosovës; Vendimin e datës 21.09.2021 me numër të protokollit 3348/2021; Vendimin e datës 11.10.2021 me numër të protokollit 3348/2021/-2; Vendimin e datës 30.06.2021 me numër të protokollit 2186/2021;

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesi
sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës, gjegjësisht Vendimin Nr.26/2018 të datës 15.02.2018 të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, është vërtetuar se ankuesi mban pozitën e Drejtorit të Qendrës Kinematografike të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, lidhur me kompetencën lëndore, ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 2 paragrafin 4 i cili ka përcaktuar se: *Nëpunës i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike*", dhe si rrjedhojë ka konstatuar se pozita e Drejtorit të Përgjithshëm të Qendrës Kinematografike të Kosovës nuk hynë në kategorinë e pozitave me status të Nëpunësit Civil, por e njëjta hynë në kategorinë e pozitave të Nëpunësve të Shërbimit Publik.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për praninë në Shërbimin Civil si dhe duke marrë parasysh konstatimin se ankuesi ka statusin e Nëpunësit të Shërbimit Publik, Kolegji konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.849/2021 të datës 05.10.2021 të parashtruar nga ankuesi.

Sipas dispozitave të nenit 74 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publik, Nëpunësi i Shërbimit Publik, kur pretendon se i janë shkelur të drejtat nga marrëdhënia e punës mund të ankojë të punëdhënësin, dhe pastaj mund të iniciojë kontest pune në gjykatën kompetente.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.849/2021

Ilire Mehmeti-Shaqiri

[Signature]
Procesmbajtëse



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit;
- Arkivit të KPMSHCK- së;